Kontrata e Shitësit në BalkMall

Në mënyrë që të shisni produkte në https://www.balkmall.com ju duhet të pranoni kushtet e kësaj kontrate të shkruara më poshtë si dhe Termat dhe Kushtet dhe Privatësia që ndodhen në faqen tonë të internetit. Duke listuar produkte në faqen tonë të internetit ju pranoni të merrni të gjitha detyrimet dhe përgjegjësite që vijnë nga kjo kontratë.

Marketplace

BalkMall ofron platformën e saj për t'i ofruar Shitësve të listojnë dhe të shesin produktet e tyre tek blerësit. BalkMall nuk vepron si agjent për asnjë nga palët, Shitësit apo Blerësit. Shërbimi ynë konsiston në ofrimin e platformës në të cilën do të kryhen këto transaksione.

Hapja e Llogarisë së Shitësit

Ju duhet të Aplikoni për Shitës duke hapur një llogari, në mënyrë që të mund të shisni ose bleni në BalkMall. Ju jeni përgjegjës për ruajtjen e fjalëkalimit tuaj. Gjithmonë duhet të jepni informacion të saktë dhe të plotë dhe duhet ta mirëmbani duke përditësuar ndryshimet që bëni. Çdo përdorim i llogarisë tuaj do të merret i mirëqenë fakti që është përdorur nga ju. BalkMall do të mbështetet tek informacionet e dhëna nga ju në llogarinë tuaj. Llogaria juaj nuk mund të transferohet tek të tretë.

Kërkesa Ligjore

Për të listuar produkte në BalkMall ju duhet të jeni në moshë madhore dhe ligjërisht i aftë për të hyrë në marrëdhënie kontraktuale me të tjerë. Minorenët nuk lejohen të shesin ose të blejnë në BalkMall. Për të listuar produkte, ju duhet të jeni të regjistruar në QKB dhe të jeni të pajisur me NIPT. Nëse për arsye të ndryshme ju nuk figuroni më në QKB dhe nuk keni NIPT, atëherë do t’ju hiqet aksesi nga llogaria juaj deri në rihapjen ose riregjistrimin tuaj në QKB.

Tarifat e Marketplace

Në BalkMall ka plane të ndryshme nga ku Shitesit mund të zgjedhin. Planet janë me Limitim në numrin e produkteve, tarifa të ndryshme mujore si dhe përqindje për transaksion. Për të parë të gjithë Planet e ofruar ju lutem të vizitoni faqen tonë të internetit. Duke listuar produkte në BalkMall ju pranoni të paguani tarifat dhe detyrimet e nënshkruara në këtë kontratë.

Komunikimi me Blerësit

Ju kërkohet t'i ofroni suportin e nevojshëm blerësve të marketplace në një kohë të arsyeshme. Në mënyrë ideale të gjithë mesazheve duhet t'i kthehet përgjigje brenda 24 orëve. Ju lutem, nëse është e mundur zgjidhni të gjitha mosmarrvëshjet e mundshme brenda 48 orëve. Ju kërkohet të ndryshoni Statusin e Porosisë pas çdo procesi pasi, për çdo ndryshim në Statusin e Porosisë Blerësi do të njoftohet me email, në mënyrë që të jetë në dijeni të porosisë së tij pas çdo hapi.

Transporti

Ideale do të ishte nëse çmimi i transportit do të ishte i përfshirë në çmimin e produkteve në mënyrë që të ofrohet transport falas. Ju mund të përdorni transportin e ofruar nga BalkMall ose një shërbim tjetër që dëshironi ju. Të gjitha porositë duhet të nisen në mënyrë që të shkojnë tek Blerësit sa më shpejt. Në Tiranë porositë duhet të mbërrijnë brenda 48 orëve (preferohet brenda 24 orëve) dhe për rrethe brenda 72 orëve (preferohet brenda 48 orëve) që nga momenti i porosisë.

Kufizimet e Shitësit

Çmimet e produkteve të listuara në BalkMall duhet të jenë të njëjta ose më të lira me çmimet e postuara në faqen e internetit të shitësit ose në rrjetet sociale të tij, jo më të shtrenjta.

Shitësit nuk mund të listojnë ose shesin produkte që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale, produkte të jashtëligjshme, fallco, kopje ose produkte të vjedhura. Produktet e listuara për shitje duhet të listohen në kategorinë e duhur, me foto të produktit si dhe një përshkrim i saktë rreth produktit. Blerjet midis palëve duhet të bëhen nga website ose të regjistrohen si të tilla nëse janë bërë me telefon ose rrjetet sociale, dhe që kanë ardhur nga BalkMall.

Produktet e listuara nga ju duhet të aprovohen nga BalkMall dhe pastaj mund të shfaqen në marketplace. BalkMall rezervon të drejtën të ndalojë shitjen e produkteve të caktuar në marketplace. Shitësit duhet të listojnë vetëm produktet që kanë në gjendje dhe të përditësojnë stokun në mënyrë periodike. Shitësit janë të detyruar të shesin produktet në çmimet e listuara në marketplace.

Duke listuar produkte në BalkMall, ju zotoheni që keni të drejtë të shisni produktet në fjalë, keni gjendje dhe përshkrimi i bërë është i saktë dhe i plotë. Shitësit duhet të dërgojnë porositë në afatet e caktuara. Në rast të mos dërgimit të porosive në afatet e përcaktuara mund të bëhet shkak për mbyllje të llogarisë tuaj të Shitësit.

Taksat

Të gjitha Taksat që vijnë si detyrime nga transaksionet e kryera në BalkMall midis Shitësit dhe Blerësit janë detyrime të Shitësit. Në rast të mos deklarimit, pagimit ose shlyerjes së detyrimeve që vijnë nga taksat nga ana e Shitësit, BalkMall nuk ka asnjë detyrim dhe nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi ligjore.

Kthimi, Ndërrimi dhe Kompensimi

Me firmosjen e kësaj kontrate shitësit janë të detyruar të pranojnë Kushtet për Kthimin, Ndërrimin dhe Rimbursimin që janë të shkruara në faqen e Internetit.

Përfundimi i kontratës

BalkMall ka të drejtë të monitorojë aktivitetin e Shitësit nëse Kushtet e kontratës ose detyrimet ligjore thyhen. Çdo aktivitet i jashtëligjshëm ose mashtrim do të raportohet në instancat ligjore përkatëse. Në rast përfundimi të kontratës, Shitësi është i detyruar të paguajë çdo detyrim që ka ndaj BalkMall deri në momentin e prishjes së kontratës.

Mosmarrëveshjet

Çdo mosmarrëveshje midis Shitësit dhe Blerësit pritet të zgjidhet midis palëve. Në rast të kundërt do të ndërhyjë BalkMall për të zgjidhur mosmarrëveshjet.

Kontenti

Duke pranuar kushtet e kësaj kontrate, ju na autorizoni të drejtën e përdorimit të kontentit që vendosni në BalkMall. Ju zotoheni të përdorni Kontentin tuaj ose Kontent që keni të drejtë për ta përdorur. Ju do të jeni përgjegjës për çdo shkelje që vjen si pasojë e përdorimit të pa autorizuar të të drejtave të autorit.

Ligjshmëria

Nëse ndonjë pikë e kësaj kontrate bie ndesh me ligjet e Republikës së Shqipërisë atëherë ajo do të jetë e pavlefshme, ndërsa pjesa tjetër e kësaj kontrate do të jetë e vlefshme.

Na Kontaktoni

Nëse keni ndonjë pyetje apo paqartësi rreth Kontratës së Shitësit atëherë jeni të lutur të na kontaktoni.